



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit, mbajtur më 10.11.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Drilon Pireva (PSD), Nol Nushi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Arbër Vokri (LVV), Naim Hoxha (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Berat Lahu (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Naime Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vjollca Rizani (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Suzan Kika, (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Adelina Fazliji (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur), Valbona Petrovci (e pavarur) dhe Sokol Berisha (Grupi i pavarur).

Munguan: Migjen Shala (PDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi - Gorani (PSD), Mirsad Vitia (LVV), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur) dhe Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Florim Krasniqi, përfaqësues i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. **Shefki Gashi**. **Kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Halim Halimi kërkoi që në rend të ditës të futet pika: "Kompensimi i shujtës për punëtorët - shërbyesve civilë të Komunës së Prishtinës.

Për propozimin e dhënë nga z. Halimi u pajtuan të gjitha grupet e tjera parlamentare.

Osman Bllaca tha se ky propozim duhet të futet në rend të ditës edhe është mirë që të votohet prej anëtarëve të Kuvendit. Këto mjete do të merren në formë të materialeve e jo në formë të mjeteve financiare, pra do të merren në market gjëra ushqimore në vlerë diku prej 300 euro.

Shpend Ahmeti kërkoi që në rend dite të futet edhe pika: “Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban “D2” në kuadër të Planit rregullues “Arbëria 3”, të miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01 nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.

Egzon Azemi edhe kësaj radhe kërkoi nga të gjithë asamblastët pa dallim, që të votojnë, ta diskutojmë secilën ngjarje që ka ndodhur në NPB tash e sa kohë, pra kërkoi që në rend të ditës për diskutim të futet edhe pika: “Diskutim për Ndërmarrjen Publike Banesore”.

Bashkim Beha dha sqarime, duke thënë se unë e kamë refuzuar detyrën e UD-së të kryeshefit të Ndërmarrjes Publike Banesore. Ai vendim nuk është i plotfuqishëm dhe është për çudi se si ka ardhur ai këtu.

Dren Kukaj, në cilësinë e aksionarit të Ndërmarrjes Publike Banesore, tha se ai vendim është i jashtëligjshëm, për shkak se në momentin kur është marrë ky vendim, gjysma e anëtarëve të Bordit kanë qenë të shkarkuar dhe nuk kanë pasur kuorum për ta marrë një vendim të tillë, andaj i njëjti asnjëherë nuk ka hy në efekt edhe nuk ka arritur as të protokollohet në NPB.

Muhamet Selmani tha se sa i përket notës verbale të Ambasadës amerikane, sipas ligjit në fuqi, ne nuk kemi të drejtë me dhënë toka në shfrytëzim se është kundërligjore.

Lidhur me shqetësimet e ngritura rreth këtij propozimi, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti, kryetar.

Sami Boroci u shpreh se do të ishte mirë që të jetë një seancë e jashtëzakonshme për të diskutuar rreth zhvillimeve të fundit në Ndërmarrjen Publike Banesore.

Kryesuesi i hodhi në votim pikat e propozuara, që ato të hyjnë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 7 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, nuk u miratua propozimi i dhënë nga Egzon Azemi, që në rend të ditës të futet pika: “Diskutim për Ndërmarrjen Publike Banesore”.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi:
"Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e Administratës së Komunës së Prishtinës, që të hyjnë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua propozimi për kërkesën e Ambasadës amerikane: "Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishtëm të bllokut urban "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01 nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015, që të futet në rend të ditës për diskutim.

Me ndryshime dhe plotësimet e dhëna, më 28 vota për dhe 1 kundër, u miratua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2021 (TM3);
3. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve Komunës së Preshevës me rastin e fatkeqësive natyrore;
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës;
5. Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2022;
6. Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishtëm të bllokut urban "D2", në kuadër të planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendim për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015;
7. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria";
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 3 shtator 2021 (TM3).

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 3 shtator, 2021 (TM3).

Pika e tretë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve Komunës së Preshevës me rastin e fatkeqësive natyrore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 34 vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve Komunës së Preshevës me rastin e fatkeqësive natyrore.

Pika e katërt

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndarjen e mjeteve Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Kryesuesi konstatoi se më 16 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimin të pjesërishtëm të bllokut urban "D2", në kuadër të planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendim për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Shpend Ahmeti, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 30 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e ndryshimit dhe plotësimin të pjesërishtëm të bllokut urban "D2", në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar me Vendim për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria".

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Florim Krasniqi, përfaqësues i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan Leonora Shabani-Bajraktari, Agim Gashi, Granit Shala, Blerand Stavileci, Muhamet Selmani, Ardian Olluri dhe Fiknete Bejta.

Përkitazi me vërejtjet e parashtruara nga parafolësit rreth këtij propozimvendimi, sqarime shtesë dhanë Shpend Ahmeti, kryetar, dhe Florim Krasniqi.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria".

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e Administratës së Komunës së Prishtinës.

Lidhur me këtë propozimvendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Shpend Ahmeti, kryetar.

Për këtë propozimvendim diskutuan Agim Gashi, Naim Hoxha, Muhamet Selmani, Dren Kukaj dhe Halim Halimi.

Kryesuesi theksoi se ndarja e këtyre mjeteve financiare për punëtorët e Administratës së Komunës së Prishtinës deri në vlerë prej 300 euro, do të jetë në artikuj ushqimor.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 27 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e administratës së Komunës së Prishtinës.

Pika e dhjetë

Të ndryshme.

Shpend Ahmet, kryetar, i falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës për bashkëpunimin e ndërsjellë gjatë këtij mandati.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
(në mungesë të kryesuesit)
Shefki Gashi**

Faqe5nga5